



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 04, datë 07.03.2016

PËR

RISHIKIMIN E KUSHTEVE TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “NDËRTIMI  
DHE RIKONSTRUKSIONI I ZYRAVE TË ADMINISTRATËS SË OPERATORIT TË  
SHPËRNDARJES SË ENERGISË ELEKTRIKE (OSHEE) SH.A”, NË BULEVARDIN  
“GJERGJ FISHTA”, BASHKIA TIRANË, MIRATUAR NË KKT ME VENDIM NR. 2,  
DATË 01.04.2015

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” dhe Vendimit Nr. 2, datë 01.04.2015 “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për “Ndërtimin dhe Rikonstruksionin e Zyrave të Administratës së Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a”, me subjekt kërkues “OSHEE” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit

VENDOSI:

1. Miratimin e rishikimit të kushteve të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi dhe Rikonstruksioni i Zyrave të Administratës së Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a”, me vendndodhje në Bulevardin “Gjergj Fishta”, Bashkia Tiranë, miratuar në KKT me Vendim Nr. 2, datë 01.04.2015, me subjekt kërkues shoqërinë “OSHEE” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI SHQIPËRISË

EDI RAMA






**ZËVENDËS KRYETAR I KKT**

**EGLANTINA GJERMI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN**



**SEKRETAR I KKT**

**LEDIA TOTA**

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

